

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J
Nr.10 074, datë 12.2.2009

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES USHTARAKE TË GRANTIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ushtarake të grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

MARRËVESHJA USHTARAKE
E GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë, duke riafirmuar dhe njëherë marrëdhëniet e tyre të gjata miqësore, duke iu referuar marrëveshjes së bashkëpunimit në fushat e trajnimit ushtarak, teknikës dhe shkencës, datë 29 korrik 1992 dhe marrëveshjes së bashkëpunimit dhe trajnimit ushtarak të datës 19 nëntor 1992, dhe me qëllim forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe kontributit për ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kanë rënë dakord, si më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Turqisë do t'i japë një grand prej 969 000(nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Grandi do të jetë i disponueshëm nga viti 2008.

Neni 2

Si pjesë e kësaj marrëveshjeje, grandi prej 897 750(tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë)lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të sigurohet në materiale dhe shërbime, 71 250(shtatëdhjetë e njëmijë e dyqind e pesëdhjetë) ekuivalente në dollarë amerikanë, do të sigurohet në formë leku, në përputhje me ligjet e brendshme përkatëse të Republikës së Turqisë.

Neni 3

Grandi prej 969 000(nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të realizohet në përputhje me protokollin e ndihmës financiare dhe zbatimit logjistik, të cilat do të nënshkruhen veçmas ndërmjet zyrtarëve të të dyja palëve të referuara në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Republika e Shqipërisë bie dakord të mos ia transferojë titujt, pronësinë e artikujve/shërbimeve një vendi tjetër ose pale të tretë, pa pëlqimin paraprak të Republikës së Turqisë.

Neni 5

Marrëveshja do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit për përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj nga secila palë. Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi derisa të gjitha materialet dhe shërbimet, siç përcaktohet në protokollin e zbatimit, t'i jepen Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshja e grandit do të zbatohet nga Shtabi i Përgjithshëm Turk në emër të Republikës së Turqisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Çdo mosmarrëveshje e lindur gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me diskutime dhe bisedime dypalëshe.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në gjuhën shqipe, turke dhe angleze. Në rast mospërputhjeje, lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti anglisht i Marrëveshjes do të mbizotërojë.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar më 10 2008, në Ankara të Turqisë.

**NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Altin Kodra

Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Ankara-Turqi

**NË EMËR TË QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË TURQISË**

**Semih Cetin
Gjeneral Brigade**

Zëvendësdrejtör i Departamentit të Zhvillimit të Forcës dhe Menaxhimit të Burimeve